



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 27.3.2014, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci, Sami Hamiti, Vlora Dumoshi, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra - Ibrahim, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Sylejman Pireva, Genc Sherifi, Hatixhe Hoxha, Qendron Kastrati, Ylli Hoxha, Fisnik Ismajli, Teuta Krasniqi, Sadri Ramabaja, Shaip Shabani, Lirak Çelaj, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Floriana Rugova, Laura Zherka, Remzi Pacolli, Islam Pacolli, Mirlinda Sopi, Sofije Bunjaku, Imer Rusinofci, Besa Rafuna, Fadil Gashi, Brahim Mehmetaj, Abetare Fazliu, Feti Mehdiu, Kimet Zeqa, Visar Arifaj, Nenad Miladinoviq dhe Cuneyd Ustaibo.

Munguan: Puhie Demaku, Hatixhe Latifi – Pupovci, Memli Krasniqi, Rita Begolli dhe Blerand Stavileci.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues i Kuvendit.

Pra se të fillonin me diskutimin e pikave të rendit të ditës, u hap debati rreth rendit të ditës. **Agim Gashi** tha se për seancat e Kuvendit, këshilltarëve duhet t’iu dërgohen materialet 7 ditë përpara, pasi t’i kalojnë procedurat paraprake. Qëllimi i dërgimit të materialeve është që këshilltarët të kenë kohë të përgatiten lidhur me pikat e rendit të ditës dhe të japin kontributin e tyre në vijimësi në mbledhjet e Kuvendit. Sugjeroi që të mos praktikohet më tutje që në mbledhje të futen pika të rendit të ditës, ku asnjë fjali, si material udhëzues për këshilltarët nuk iu dërgohet atyre. Do të ishte shumë korrekte dhe shumë zyrtare, miqësore dhe bashkëpunuese, në qoftë se për pikën e tetë, do të ishin dhënë dy fjali, tri udhëzime, se çfarë do të diskutojmë për lagjen “Dodona”.

Ylli Hoxha, lidhur me rendin e ditës, i paraqiti tri çështje, për të cilat tha se janë më se të domosdoshme që të futen në rendin e ditës për diskutim, e të cilat janë:

E para, ka të bëjë me çështjen e nepotizmit, si temë të cilën e kam propozuar në mbledhjen e KPF-së, e që është dashtë të jetë në ren dite.

E dyta, ka të bëjë me pikën e transferimit, shkëmbimit të pronës, çështje të cilat kanë të bëjnë me dëmtim të pronës publike, me sistem jo kompetent, jo cilësor, jo të sigurt të menaxhimit

të pronave, ku kemi të bëjmë me tentativa të fshehjes së informacioneve nga kjo asamble. Rrjedhimisht kemi gjetur pajtimin e plotë që, 2 prej 4 propozimpronave të hiqen nga diskutimi, ndërsa për 2 pikat tjera të mbetura, kemi kërkuar nga administrata, Kryetari dhe drejtoritë përkatëse që të bëjnë verifikimin e ligjshmërisë së tyre.

E tretë, ka të bëjë me raportet e komisioneve të aksionarëve. Kemi kërkuar raporte sipas Ligjit për menaxhimin e ndërmarrjeve publike, raporte të cilat duhet të sillen nga aksionarët e ndërmarrjeve publike. Nga raportet e kërkuara, vetëm "Trafiku Urban" e ka kryer detyrën e vetë.

Konsideroj se të tri çështjet duhet të futen në votim.

Lidhur me çështjet e ngritura nga z. Hoxha, **Kryesuesi** dha sqarime të nevojshme.

Shefki Gashi, lidhur me çështjet e ngritura nga z. Hoxha, tha se ato nuk qëndrojnë, andaj kërkoi nga kryesuesi që të fillohet me rendin e ditës ashtu si është propozuar.

Lirak Çelaj sugjeroi që t'i përmbahen rendit të ditës, të mos lejohet të keqpërdoret foltoja, sepse ne tani po flasim për rendin e ditës, andaj të jemi më konkret në këtë aspekt. Lidhur me këtë shtoi se, pajtohem plotësisht me propozimin e z. Gashi për pikën e tetë të rendit të ditës, që të hiqet, sepse nuk kemi pasur asnjë material dhe nuk kemi për çka të diskutojmë, të debatojmë. Pajtohem edhe me propozimin e Yllit, që të hiqet nga rendi i ditës "Raporti i komisioneve komunale të aksionarëve", sepse nuk i kemi materialet e plota. Pas konstituimit të bordeve të reja të aksionarëve, ato duhet të merren me këto raporte dhe ato pastaj të na e sjellin një raport. Të njëjtën gjë edhe për Raportin vjetorë të punës së Kryetarit të Komunës, të shtyhet për seancën e ardhshme, me shpresë se do të na vjen një raport më i detajuar, mbi të cilin mund të diskutojmë diçka.

Vjollca Dibra-Ibrahimi kërkoi të dijë se për çfarë arsye nuk është sjellë në Kuvend propozimvendimi për memorialin "Heroinat", propozim që ka kaluar në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve në nëntor të vitit 2013.

Sadri Ramabaja tha se plotësisht pajtohem me propozimin e Yllit, andaj dhe insistojmë që çështja që ka të bëjë me nepotizmin, të jetë gjithsesi në rend të ditës.

Muhamet Selmani propozoi që pika e shtatë dhe e tetë e rendit të ditës, të diskutohen veç e veç, ashtu siç e parasheh ligji, andaj dhe e marrim një vendim në këtë Kuvend, se si do të procedohet për secilën lëndë veç e veç.

Islam Pacolli propozoi që të fillohet me rendin e ditës, ashtu si është propozuar. Lidhur me propozimvendimet për pronat, të cilat kanë konteste gjyqësore, tha se nuk do të duhej të sillëshin fare në Kuvend. Ai e përgëzoi Komunën e Prishtinës për emërtimin e shkollës së re në fshatin Hajvali me emrin "Afrim Gashi".

Brahim Mehmetaj kërkoi nga kryesuesi që në të ardhmen fillimisht të aprovohet rendi i ditës, që më pas të fillohet me diskutimin e pikave të rendit të ditës.

Sami Hamiti tha se sa u përket raporteve të komisionit të aksionarëve, kërkoj nga të gjithë anëtarët e komisioneve të legjislaturës së kaluar, t'i marrin dhe t'i kryejnë raportet, në mënyrë që t'i sjellin këtu në Kuvend. Sa i përket pikës së shtatë dhe të tetë, tha se ato vendime që i kemi marrë nga Ministria e Pushtetit Lokal, janë trajtuar si të ligjshme, andaj mbetet që këto të procedohen më tutje.

Shpend Ahmeti, Kryetar, tha se ka vendime nga Bordi i Drejtorëve i mandatit të kaluar, të cilat i janë proceduar Kuvendit, dhe tani ato unë nuk mund t'i kthej pa e marrë autorizimin nga Kuvendi, në mënyrë që të merrem prapë me këto lëndë.

Duke pasur për bazë diskutimet e parashtruara, kryesuesi i hodhi në votim një nga një të gjitha këto pika të

RENDIT TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e dytë e Kuvendit;
2. Propozimvendimin për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës - njëzëri u miratua për shqyrtim;
3. Propozimvendimi për themelimin e komitetit konsultativ - njëzëri u miratua për shqyrtim;
4. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2013 në vitin 2014 - njëzëri u miratua për shqyrtim;
5. Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës, raport përfundimtar përmbledhës për vitin 2013 - dhjetë kundër;
6. Raportet e komisioneve komunale të aksionarëve, (shqyrtohet vetëm raporti i Trafikut Urban);
7. Propozimvendimi përfundimtar për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (vetëm diskutim) - një për, shtatë kundër;
8. Diskutim për lagjen "Dodona" - një kundër;
9. Informata për gjendjen e furnizimit me ujë në komunën e Prishtinës - miratohet njëzëri;
10. Pyetje dhe përgjigje - miratohet njëzëri;
11. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e dytë e Kuvendit.

Sadri Ramabaja bëri vërejtje për pikën e nëntë, konkretisht në faqen 17 të transkriptit, duke cekur se ka shumë gabime gjuhësore, të cilat e humbin komplet kontestin kuptimor të fjalisë. Në këtë faqe ka edhe gabime të karakterit logjik, ku në vend të fjalës "kurrikulë", është shkruar "kutikulë". Ai kërkoi që gabime të tilla të mos përsëritën më.

Sylejman Pireva u shpreh se kur e shoh një tekst të mbytur nga gabimet gjuhësore, jo vetëm ortografike, por edhe logjike e sintaksore, vërtetë nuk më tërheqë as për përmbajtjen që ta lexoj. Vërejtje për pikën e pestë, konkretisht në dymbëdhjetë rreshtat e parë të raportit të Drejtorisë së Inspektionit, janë lëshuar shumë gabime.

Me vërejtjet e dhëna, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në pika të shkurtra informoi kryesuesi, i cili tha se përveç komiteteve obliguese, duhet të themelohen edhe këto komitete jo obliguese:

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
2. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
3. Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Rural,
4. Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
5. Komiteti për Shërbime Publike dhe
6. Komiteti për Pronë.

Anëtarë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, u propozuan:

1. Ajnishahe Azemi, LDK,
2. Hatixhe Latifi-Pupovci, LV,
3. Kimete Zeqa, PD,
4. Besa Rafuna, LDD,
5. Mirlinda Sopi, AKR,
6. Lirijeta Rexhepi, PDK,
7. Hasime Krasniqi, LDK,
8. Sakiba Jashari, (komuniteti boshnjak) dhe
9. Ebru Grozda (komuniteti turk).

Anëtarë të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, u propozuan:

1. Agim Gashi, LDK,
2. Fisnik Ismaili, LV,
3. Sofije Bunjaku, AKR,
4. Lirie Avdiu, PDK,
5. Flamur Shala, LDK,
6. Feti Mehdiu, PD,
7. Vjollca Dibra - Ibrahim, LDK,
8. Visar Arifi, PF dhe
9. Daniel Gjoshiq, (komuniteti serb).

Anëtarë të Komitetit për Zhvillim Rural, u propozuan:

1. Muhamet Selmani, PDK,
2. Genc Sherifi, LV,
3. Lirak Çelaj, PDK,
4. Sylejman Pireva, LV,
5. Sokol Krasniqi, LDK,
6. Naime Osmani, LDK,
7. Bekim Gashi, LDK,
8. Sergjan Vasiq, (komuniteti serb) dhe
9. Mucjela Meshekran, (komuniteti turk).

Anëtarë të Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, u propozuan:

1. Laura Zherka, PDK,
2. Qëndron Kastrati, LV,
3. Arsim Gosalci, AKR,
4. Ylli Hoxha, LV,
5. Teuta Krasniqi, LV,
6. Mustafë Krasniqi, LDK,
7. Hajrush Bajraliu, LDK,
8. Nenad Miladinoviq, GI SRPSKA dhe
9. Alp Domanik, (komuniteti turk).

Anëtarë të Komitetit për Shërbime Publike, u propozuan:

1. Puhije Demaku, LV,
2. Remzi Pacolli, AKR,
3. Rita Begolli, AAK-LDD,
4. Abetare Fazliu, LB,
5. Blerand Stavileci, PDK,
6. Shaip Hajrizi, LDK,
7. Merita Surkishi, LDK,
8. Dragan Miladinoviq, (komuniteti serb) dhe
9. Adnan Ajeti, (komuniteti rom).

Anëtarë të Komitetit për Pronë, u propozuan:

1. Brahim Mehmetaj, LB,
2. Hatixhe Hoxha, LV,
3. Fadil Gashi, AAK-LDD,
4. Shaip Shabani, PDK,
5. Abit Kastrati, LDK,
6. Shefki Gashi, LDK,
7. Feim Salihu, LDK,
8. Gyldan Bekteshi, (komuniteti turk) dhe
9. Faik Marolli, (komuniteti ashkali).

Njëzëri u miratua vendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për themelimin e Komitetit Konsultativ, në pika të shkurtra informoi Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore.

Kryesuesi njoftoi se në bazë të konsultimeve që janë bërë me shefat e GP-ve, në panelin përzgjedhës për Komitetin Konsultativ janë propozuar:

1. Sami Hamiti LDK,
2. Ylli Hoxha LV,
3. Lirak Çelaj, PDK,
4. Islam Pacolli, AKR, dhe
5. Brikena Avdyli, propozohet nga shoqëria civile.

U konstatua se njëzëri u themelua Komiteti Konsultativ dhe paneli përzgjedhës i këtij komiteti, në përbërjen e cekur më lart.

Pika e katërt

Lidhur me Propozimvendimin për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2013 në vitin 2014, në pika të shkurtra informoi Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, i cili ceku shumën e bartjes së mjeteve nga viti 2013 në vitin 2014. Njëherësh paraqiti edhe pasqyrën tabelore me të dhëna më të detajuara.

Sami Hamiti, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar vendimin e bartjes së mjeteve nga viti 2013 në vitin 2014, pra është kategori ligjore bartje e mjeteve, dhe e kemi analizuar në projekte. Është një analizë e mirë, ku dhe janë të paraqitura saktë projektet, andaj dhe shihet që shumica e mjeteve absolute janë projekte të investimeve kapitale.

Hatixhe Hoxha, në emër të GP të LV-së, tha se nga buxheti i planifikuar për vitin 2013, por i pashfrytëzuar tërësisht, në vitin 2014 u bartën 14.614.576.26 €, dhe konstatimi ynë është se kjo është një shumë e madhe buxhetore e pashfrytëzuar në vitin 2013 dhe e bartur në vitin 2014. Pyetja e jonë është se si ka mundur të mbetet një shumë kaq e madhe pa shfrytëzuar. I rekomandojmë kryetarit, z. Ahmeti, të ketë parasysh që në të ardhmen të mos mbesin shuma kaq të mëdha të pa shfrytëzuara.

Muhamet Selmani, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne e kemi shqyrtuar këtë propozim dhe parimisht jemi për bartjen e këtyre mjeteve, mirëpo paraprakisht i kam disa pyetje dhe disa sugjerime.

E para, kur është çështja e pagave dhe mëditjeve, nuk thuhet për çfarë arsye janë këto paga, thuhet për arsimin fillor dhe të mesëm. A është kjo mbulesë, apo këto mjete të cilat duhet ti bartim për këto paga, për çfarë arsye kanë mbetur, a janë si shtesë, punë jashtë orari etj?

Sa i përket investimeve kapitale, sugjeroj që planifikimi i investimeve të projekteve të jetë i saktë. Te subvencionet, do të ishte mirë që të merret parasysh, në rast se ka mjete, të ndihmohen klubet sportive në komunën e Prishtinës.

Islam Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se edhe ne e kemi shqyrtuar këtë përgatitje të bartjes së mjeteve, sigurisht është edhe e pranueshme, por ne kemi një sugjerim, që këto mjete të shpenzohen gjatë këtij viti, që është e paraparë edhe të mos mbesin projektet e parealizuara. Sugjerimi i tij ishte që gjatë realizimit të projekteve, të zhvillohet një kontroll më i thukët dhe mjetet të cilat janë të dedikuara të trajtohen në mënyrë të duhur, të mos keqpërdoren. Kërkoj që objekti i BL të fshatit Hajvali të pajiset me mjete kompjuterike, si dhe të bëhet ndërtimi i dy kanalizimeve, të cilat pas ndërtimit të rrugëve kanë mbetur të hapura.

Imer Rusinovci, në emër të GP-së së AAK-LDD-së, tha se edhe ne e përkrahim bartjen e buxhetit nga viti 2013 në vitin 2014.

Feti Mehdiu, në emër të GP-së së PD-së, tha se përveç atij sugjerimi që ishte te arsimi, që e bëri një koleg paraprak që ta përkrahim te arsimi, duhet të jenë më të qarta punët çka mendohet dhe çka investohet. E përkrahim këtë propozimvendim për bartjen e mjeteve.

Brahim Mehmetaj, në emër të GP-së së LB-së, theksoi se edhe ne në parim e përkrahim këtë propozimvendim për bartjen e mjeteve.

Lirak Çelaj sugjeroi që për investimet e ndërtimeve sociale për banim, është më mirë të gjendet një formë tjetër, të cilën ne e kemi propozuar vazhdimisht, e që është partneriteti privato-publik, sepse kjo do ta kursente buxhetin dhe ato mjete mund të dedikohen për mirëqenie sociale, por në një formë tjetër. Ka qenë mirë edhe ai përskrimi, gëlqerosja e shkollave, disa shkolla specifikohen e disa jo, të jenë më specifike. Kjo tregon se kjo bartje është bërë pak ad-hoc.

Meqë i përkas fushës së kulturës, dëshiroj që investimet në të ardhmen të mos jenë vetëm në ruajtjen e trashëgimisë kulturore, por të ndërtohen edhe objekte të tjera për të cilat ka nevojë shumë Prishtina. Kisha propozuar që një pjesë e buxhetit të dedikohet edhe për ndonjë hapësirë tjetër, si galeri, teatër apo diçka tjetër, pra të mos orientohen vetëm në infrastrukturën sportive.

Agim Gashi tha se në këtë material, në pasqyrën e shërbimeve publike, mbrojtjes dhe shpëtimit, nuk është përfshirë bartja e mjeteve për përfundimin e projektit të Tauk- bahçes, projekt i cili është në fazën përfundimtare. E kisha lutur drejtorin që, nëse ka ndonjë sqarim për këtë, ose të pranohet kjo për arsye se në atë projekt operojnë dy kompani. Njëra operon në fushën e sportit, sa ju përket shtigjeve, dhe tjetra ka pasur pjesën tjetër të punëve, siç janë rregullimi i ambientit, pastaj rrethojave, përfundimi i fushave të tenisit dhe disa gjërave të tjera.

Shefki Gashi shprehu mendimin se menaxhimi i mjeteve buxhetore nga qeveria e kaluar, është bërë në mënyrën më profesionale ekonomike që e ka projektuar ky Kuvend i kaluar, kjo qeverisje dhe vet kryetari.

Nga viti i kaluar kanë mbetur shumë projekte pa përfunduar, që kanë qenë në proces të punimit, siç janë disa projekte të rrugëve në zonat rurale, kështu që sivjet kanë mbetur me u bartur 15 milion €, kurse në vitin e ardhshëm do të barten 25 milion €. Ai shprehu dëshirën që edhe buxhetin e ardhshëm ta menaxhojnë kësisoj.

Vlora Dumoshi theksoi se në Drejtorin e Rinisë, Kulturës dhe Sportit kanë mbetur mjaft projekte të papërfunduara, të cilat vazhdojnë, sepse janë projekte të mëdha kapitale. Një zë buxhetor ka qenë i dedikuar për artin publik, për skulptura në qytet dhe me këtë bartje të mjeteve ky zë buxhetor nuk ekziston, andaj kërkoj të dijë se a është anuluar apo çka është në pyetje.

Sadri Ramabaja sugjeroi që Drejtoria e Financave dhe e Pronës ta shikojë mundësinë që, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, të parashohin një zë të veçantë buxhetor për nevojën e domosdoshme të krijimit të mekanizmit të kontrollit të cilësisë në arsim. Do të ishte mirë që të shqyrtohet mundësia tash tek ky rast, me këtë buxhet të bartur, ose me rishikimin e buxhetit dhe ai mekanizëm të bëhet realitet.

Sylejman Pireva tha se tri çështje më interesojnë në këtë rast, kur shqyrtohet ky raport:

- A ndikon bartja e këtyre mjeteve një vit prapa në buxhetin e vitit të ardhshëm që të jetë më i vogël, apo të merret në konsideratë?

- A ka mundësi që projektet, sidomos në infrastrukturën shkollore, të menaxhohen më mirë dhe të mos harxhohen paratë kot, vetëm sa për të bërë një godinë që duket si shkollë, por vërtet të ketë një cilësi tjetër?

- A ka mundësi që të bëhet një zgjidhje e përhershme për degën e bibliotekës "Hivzi Sylejmani" në fshatin Hajvali, kur dihet se në çfarë kushtesh ekziston tani ajo?

Lidhur me vërejtjet, sugjerimet dhe pyetjet e parashtruara, sqarime të nevojshme dha **Visar Berisha**.

Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, sqaroi se ky propozimvendim ka të bëjë vetëm për ta liruar përdorimin e mjeteve prej vitit të kaluar. Neve na duhet një vendim i Kuvendit që e lejon bartjen e mjeteve, prandaj kisha thënë se për 99% të të gjitha projekteve, ky është thjesht buxheti i vitit të kaluar, të hyrat vetanake të cilat nuk kanë mundur të shpenzohen vitin e kaluar, tash vetëm barten në vitin 2014.

Njëzëri u miratua Vendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2013 në vitin 2014.

Pika e pestë

Lidhur me Raporti vjetor të punës së Kryetarit të Komunës - Raporti përfundimtar përmbledhës buxhetor për vitin 2013, të pranishmit i informoi Kryetari, Shpend Ahmeti, i cili tha se Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës parashihet si marrëdhënie në mes ekzekutivit dhe legjislativit, në punën e rregullt që legjislativi ka për mbikëqyrjen e punës së ekzekutivit. Në këtë rast, ne kemi një qeverisje tjetër ekzekutive, e cila e ka përfunduar mandatin dhe tash ne në një mënyrë raportojmë për punën e cila është bërë nga ekzekutivi i kaluar, dhe nuk është marrëdhënie e rregullt e mbikëqyrjes së punës së një ekzekutivi. Pranoj të gjitha kritikën se ky raport mund të

jetë jo përmbajtësor, për shkak se në shumicën e rasteve kemi marr raporte nga punëtorët, të cilat as nuk mund t'i verifikojmë deri në fund se si është puna dhe cilat janë bërë punët në mandatin e kaluar. Sugjerimi im është që ta merrni këtë si raportim formal ligjor dhe pastaj në komisione punohet në gjetjen apo raportimin sa më të mirë për punën që është bërë në vitin 2013.

Flamur Shala theksoi se Kuvendi i Komunës ka përgjegjësi për raportin, ndërsa Kryetari raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomike - financiare të

Komunës dhe zbatimin e planeve investuese të Komunës. Atë raport që e paraqiti Kryetari është logjik, sepse nuk ka ndonjë lidhje, marrëdhënie në mes Kryetarit të ri dhe ndërrimit të pushteteve, por raporti si raport formalisht duhet të jetë i përgatitur nga administrata që kontrollohet nga Kryetari i tanishëm.

Në këtë raport më shumë e kemi një përshkrim të situatës ekonomike dhe financiare që është zhvilluar gjatë vitit 2013, dhe nuk ka paraqitje krahasuese, së paku për vitin paraprak. Kemi disa krahasime, por çdo gjë është në formë të një përshkrimi dhe nuk është në formë të statistikave të mundshme, eventualisht të tabelave të cilat do duhej të ishin. Vërejtje ka në formën e përgatitjes së këtij raporti, fundja nuk kemi as preambulë, as nuk kemi titullim të mirë të këtij raporti. Këtij raporti i mungon edhe raporti i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale. Ky është një dokument zyrtar, i cili arkivohet dhe është mirë që në këtë kuptim të intervenohet, të rregullohet dhe përmbajtësohet mirë.

Ylli Hoxha u shpreh se është mirë që është sjellë ky raport dhe po zbatohet ligji në raport me raportimin vjetor. Në këtë pikëpamje nuk do të futemi në diskutim për përmbajtjen e tij, sepse konsiderojmë se bartësi i punës për të cilin është raportuar sot, nuk gjendet në sallë. Këtë raport vetëm do ta marrim si shënim, prandaj ky dokument është mirë që të arkivohet si zbatim i ligjshmërisë brenda Kuvendit, dhe kjo të përcaktohet si traditë e re e punës në Kuvendin të Komunës.

Lirak Çelaj shprehu mendimin se është një raport jo komplet dhe pothuajse nuk kemi se çka të debatojmë. Nëse hidhet në votim, ne nuk do ta votojmë, prandaj edhe kërkuam që të hiqet nga rendi i ditës, sepse nuk do duhej ta trajtonim asnjë raport kështu, sepse raportet kur sillen në Kuvend duhen të miratohen.

Feti Mehdiu tha se edhe ne e kemi analizuar pak këtë si informatë dhe si raport, dhe mendoj se nga kjo që kemi para vetes, do të kishim disa sugjerime që mund të nxirren mësim për administrim të mëtutjeshëm. Si shembull kemi nënvizuar ndërtimin e një shkollë, e që për shkak të problemeve pronësore, ka filluar dhe nuk ka vazhduar. Këtë çështje duhet ta kemi të qartë që duhet të shihet dhe herëve të tjera të mos fillojnë ndërtimet pa i sqaruar punët si duhet. Nëse votohet, ne do ta votojmë kështu si është, me këto sugjerime që mund të nxirret mësim prej kësaj.

Agim Gashi u shpreh se ky nuk është raport, është një informatë nga drejtoritë, e cila në brendi ka shumë gabime teknike dhe përmbajtësore. Në raport prezantohen dy herë raportet e ngjashme dhe nëse dikush i lexon, sheh se në qytet janë montuar 500 shporta të mbeturinave, ndërsa në raport thuhet se janë vendosur 250 shporta të mbeturinave. Kjo është në pasqyrën e donacioneve, e është edhe në pasqyrën e realizimit të projekteve kapitale. Ky është një dokument i cili ruhet, arkivohet dhe

është vlerë e të gjithëve, është i kryetarit të Komunës që pasqyron udhëheqjen e qytetarëve të komunës së Prishtinës.

Sokol Krasniqi tha se raportet kryesisht bëhen nga njerëzit profesionistë të drejtorive, siç janë shefat e sektorëve, të cilët ende janë në marrëdhënie pune.

Në fushën e zhvillimit ekonomik, fatkeqësisht një projekt siç është “Strategjia zhvillimore e Prishtinës 2013 – 2016”, ku kanë qenë të involvuar më shumë drejtori, ku është punuar me përkushtim dhe profesionalizëm, i miratuar unanimisht nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, fare nuk është prezantuar në këtë material. Sugjeroj që drejtoritë të kërkojnë më shumë prej udhëheqësve të sektorëve të cilët kanë përvoja dhe dinë t’i kryejnë këto raporte.

Sadri Ramabaja theksoi se në fillim edhe Kryetari e shpjegoi se nuk është raport i tij, por ligji i mbrapshtë i qeverisjes lokale ia imponon që ta përmbush një formalitet ligjor, çka dëshmon se edhe ligjet nganjëherë kanë zbrastësi dhe për pasojë ne ndodhemi kështu që të plotësojmë formalitetet. Megjithatë, në esencë diçka më bën përshtypje këtu, që në legjislaturën e mëhershme kemi qenë 2-3 vetë që kemi diskutuar për këto raporte, të cilat kanë kaluar krejtësisht formalisht. Mendoj se ky raport nuk duhet të miratohet, por, si të thuash, po përmbushet një akt ligjor dhe po ecet tutje.

Sugjerimet që u thanë nga Kryetari dhe të tjerët, më duket është që ligji të korrigohet, andaj si formalitet po e miratojmë e jo si përmbajtje.

Sylejman Pireva shprehu mendimin se ky raport nuk është i përkryer, janë disa çështje që nuk i takojnë këtij raporti, por ai shprehu dilemën se mëkati i kujt është ky raport që është kështu siç është.

Sami Hamiti tha se në bazë të diskutimeve u konstatua se ky raport është hartuar në bazë të shënimeve që janë dhënë nga shefat e sektorëve, andaj dhe formati i këtij raporti nuk është raport dhe si i tillë është i shkruar dobët. Konsideroj që për ta përmbushur një formë, me këto vërejtje, ta miratojmë këtë raport dhe të ecim tutje.

Mirlinda Sopi theksoi se para se ta miratohet ky raport, kërkoj të dijë se për çfarë arsye mungon raporti i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëenies Sociale.

Në bazë të diskutimeve, u konstatua se Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës – Raporti përfundimtar përmbledhës buxhetor për vitin 2013, nuk u votua dhe mbetet që ky raport të plotësohet dhe të përpunohet edhe më tej.

Pika e gjashtë

Lidhur me raportet e komisioneve komunale të aksionarëve – diskutim, kryesuesi tha se sot do ta shqyrtojme vetëm Raportin e komisionit komunal të aksionarëve të Trafikut Urban.

Hazir Borovci, në emër të anëtarit të Komisionit komunal të aksionarëve, i njoftoi të pranishmit rreth punës së këtij komisioni, duke shtuar se menjëherë pasi që NP “Trafiku Urban” i kthehet në menaxhim Komunës, Komisioni i aksionarëve, në bashkëpunim me bordin paraprak, në bashkëpunim me ekzekutivin, me Kryetarin, me Kuvendin kemi marr disa hapa. Në fillim të vitit 2013, me propozimin e Kryetarit, z. Isa Mustafa, Kuvendi i Komunës ka votuar një shumë prej 2 milion euro në bazë të planit strategjik të Komunës për investime kapitale, për blerjen e autobusëve të rinj për NPK “Trafiku Urban”. Në korrik të vitit 2013, është bërë përzgjedhja e Bordit të drejtorëve të NPK “Trafiku Urban”, një bord shumë profesional.

Si Komisioni i aksionarëve, duke pas parasysh misionin, vizionin, po ashtu edhe sfidat dhe vështirësitë, kemi ruajtur raporte brenda ndërmarrjes. Kemi ruajtur raportet me Bordin paraprak, me Bordin ekzistues dhe konform misionit që kemi pasur, kemi ruajtur bashkëpunimin.

Sami Hamiti, në emër të GP të LDK-së, tha se edhe ne e kemi analizuar këtë raport dhe kemi konstatuar se raporti është hartuar sipas ligjit. Ajo ndërmarrje nuk është në situatë të mirë financiare dhe zhvillimore. Ekzistojnë parametrat edhe fizibiliteti që është bërë dhe me kornizën afatmesme të shpenzimeve, janë ndarë mjete që ajo ndërmarrje faktikisht të mekanizohet, apo të blejë autobusë që të jetë më funksionale. Besoj që edhe ekzekutivi tash që është, e kanë në projekt dhe në program zhvillimin e asaj ndërmarrje. Parimisht, Grupi parlamentar i LDK-së e përkrah raportin për miratim.

Sadri Ramabaja, në emër të GP-së së LV-së, tha se nëse e lexojmë me vëmendje këtë raport, në fakt përgjithësisht komisionet nuk kanë funksionuar në ndërmarrjet publike, nuk kanë qenë në nivelin e përgjegjësisë në raport me bordet etj.

Ka edhe një s’përputhje logjike, sepse anëtarët e komisionit këtë punë e bëjnë krejtësisht në baza vullnetare, ndërkaq bordet janë ato që gëzojnë privilegje të veçanta. Në të gjitha raportet që kanë ardhur herëve të tjera, “Trafiku Urban” është trajtuar si tërësi, funksional, gjysmë funksional, në dështim e sipër, ka pasur edhe ide që të falimentohet dhe të shkohet në privatizim etj. Një lloj përgjegjësie dhe autokritike do duhej ta kishte si komision dhe si bord. Në fakt, nuk mund të flasim për një bord profesional që e sjell në këtë gjendje “Trafikun Urban”. Në këtë strategji të hartuar janë renditur disa objektiva që ka pasur dhe asnjë prej këtyre objektivave nuk është realizuar. Nuk bëhet fjalë për rritje të të hyrave nga biletat, aty ka dështim total, më shumë ka shpenzim nafte sesa të hyra nga biletat, sepse vetëm një linjë funksionon, të tjerat nuk i japin llogari. Në raport nuk është theksuar një fakt tragjik. Ka tridhjetë muaj që punëtorëve Trafiku Urban u ka borxh pagat, ndërkaq drejtorët kanë blerë mercedesa qysh në ditën e tretë apo të katërt që kanë shkuar atje.

Në legjislaturën e kaluar kemi insistuar që të na silltet një informatë lidhur me një letër publike që e pati bërë atëherë Sindikata e Pavarur, andaj ky komision do duhej së paku të

thoshte dy fjalë për krejt ato të gjetura, reale ose joreale, që kanë figuruar në atë letër publike. Është fakti që ky dokument mbetet si raport dhe këtu del se 80% e punëve janë bërë mirë, por në realitet nuk është gjendja e mirë. Unë nuk mund të votojë pro kësaj përmbajtje, sepse ne të gjithë e dimë se si është gjendja në atë ndërmarrje.

Lirak Çelaj, në emër të GP-së së PDK-së, tha se ky raport është përpiluar si duhet, mund të pajtohem me atë që mund të kishte edhe ndonjë ton kritik. Sa i përket pikëpamjeve tona se si ka funksionuar kjo ndërmarrje, mendoj se do duhej të caktonim një ditë tjetër për debat dhe se ne sot po e analizojmë një raport, që mendoj se është një raport korrekt, dhe në parim e përkrahim.

Sofije Bunjaku, në emër të GP-së së AKR-së, tha se edhe ne e kemi shqyrtuar këtë material dhe kemi vërejtur tërë problematikën që është paraqitur. Jemi të vetëdijshëm se ekzistojnë ato problematika dhe duhet gjithsesi Komuna të marrë një vendim për nxjerrjen e kësaj organizate nga kjo situatë momentale. Shpresojmë se në të ardhmen e afërt Komuna të vendos që të investoj mjetet e ndara për blerjen e autobusëve të rinj. Si raport vjetor e kemi pranuar dhe e votojmë për miratim.

Fadil Gashi, në emër të GP- së së AAK – LDD-së, tha se me gjithë ato vështirësi që janë në atë ndërmarrje, këtë raport të komisionit të aksionarëve e përkrahim për miratim.

Feti Mehdiu, në emër të GP-së së PD-së, tha se edhe ne në parim do ta përkrahim raportin kështu si është paraqitur. Për gjendjen e krijuar, një pjesë të fajit e ka edhe inspekcioni, që nuk e ka kryer punën si duhet. Mund të them se komisionarët e kanë kryer punën më me nder sesa Bordi. Për blerjen e autobusëve është diskutuar disa herë dhe tash del puna këtu që procedura ka shkuar në rregull, tenderi ka shkuar në rregull e autobusët nuk janë. Gjithashtu kam kërkuar këtu për rregullimin e çështjes së udhëtimit mujor të pensionistëve dhe studentëve dhe mu tha këtu në këtë Kuvend se është punë e komplikuar, nuk mund të bëhet. Mendoj që komisionarët dhe Bordi është dashur t'i shohin këto gjëra edhe ndodhë që edhe financiarisht ajo mënyrë do t'ia kishte marrë mundësinë e keqpërdorimit rreth shitjes së biletave. Ne do ta marrim përgjegjësinë çka na takon neve, por kush është më përgjegjës për atë, le të japë përgjegjësi. Pa pasur përgjegjësi nuk shkohet përpara. Dikush duhet të japë përgjegjësi.

Brahim Mehmetaj, në emër të GP-së së LB-së, tha se ky raport nuk duhet miratuar nga ana jonë, për shkak se nuk kemi qenë pjesë e asaj pune. E kemi bërë një investigim, kemi marr një informatë prej atje se gjendja është e rëndë.

Në aspektin teknik, raporti është i përpiluar mirë, por për pjesët tjera të punëve që janë bërë atje, mendoj se duhet të bëhet një auditim i përgjithshëm dhe të definohen problemet dhe arsyet se pse ka ardhur në këtë gjendje Trafiku Urban.

Shpend Ahmeti, Kryetar, theksoi se komisioni i ri i aksionarëve duhet ta marrë punën përsipër në mbikëqyrjen edhe të Bordit edhe në sanimin e gjendjes.

Më 2 prill, me ftesë të Komunës së Prishtinës, vjen një delegacion i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ku vjen edhe kryesuesi i transportit publik të qyteteve, të cilët së bashku me Komunën e Prishtinës, do të bazohen në dy raportet e mëhershme të një kompanie gjermane dhe të USAID-it, dhe do të punojnë në përpilimin e hapave dhe strategjisë për reformimin e transportit publik dhe trafikut urban në komunën e Prishtinës.

Kemi rivendos kontakte edhe me firmën japoneze "Xhajka", ku edhe formalisht do të bëjmë kërkesë që ta ripërtërinë atë ofertë që e kanë pasur për dhënie e 40 autobusë falas për Komunën e Prishtinës. Për këtë, mendoj se nga shtatori do të vjen edhe qëndrimi i tyre se a e kanë të paraparë, edhe pse kemi parë një gatishmëri fillestare.

Ylli Hoxha kërkoi të dijë se çfarë kriteresh janë përdorur kur është konstatuar se plani emergjent është zbatuar 80%, pasi që një konstatim të tillë e kam të paqartë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e parashtruara rreth Raportit të komisionit komunal të aksionarëve, **Hazir Borovci** dha sqarime të nevojshme.

Me 26 vota për, 3 kundër dhe 5 abstenime, u miratua Raporti i komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Trafiku Urban".

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimvendimin përfundimtar për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (i Vendimit 01 nr. 046-157056, të dt. 27.08.2013), të pranishmit i njoftoi Shpend Ahmeti, Kryetar, duke thënë se janë tri propozimvendime për këmbim të pronave, të cilat janë bërë si vendime në gusht të vitit të kaluar nga ekzekutivi i kaluar.

E para, është prona e Mifail Cakollit, e cila është një pronë mu në mes të Parkut të Gërmisë. Pas realizimit të projektit të shtigjeve, del se ajo pronë nuk është pronë komunale dhe atij duhet t'i kompensohet toka.

E dyta, është toka e pronarit Ukshin Menxhiqi, kompania "Bingo - Benz", të cilit i është shpronësuar toka dhe i është ofruar një tokë tjetër për këmbim, e cila, sipas disa informatave, është në kontest gjyqësor.

E treta, është kompania "Kosova Shped", me pronarët Pjetër Palushi, ku për këmbim i është ofruar toka në lagjen "Lakërishta", e cila nuk po mund të verifikohet sakët nga kadastri. Derisa ta qartësojmë komplet situatën se çka është me këto toka, nuk mundemi të marrim asnjë qëndrim.

Agim Salihu i njoftoi të pranishmit rreth këmbimit të pronave të rregulluara sipas ligjeve përkatëse.

Sami Hamiti, në emër të GP të LDK-së, tha se po t'i referohemi këmbimit të pronës së pronarit të "Bingo - Benz"-it në aspektin normal juridik, është vlerësuar si vendim i ligjshëm dhe kemi konsideruar, sepse edhe Ministria e ka vlerësuar si të ligjshëm dhe tani po dalin probleme në ndërkohë. Po del që është një vendim i Gjykatës që në momentin kur kemi vendosur, atëherë nuk ka qenë, edhe sigurisht se nuk do të kishim vendosur, unë vet nuk e kisha votuar, kështu që parimisht kryetari le të merr për sipër, me pjesën e ekzekutivit, me drejtorë të drejtorive, dhe le të përgatitet rasti i parë, i dytë dhe i treti dhe e procedojmë sipas kësaj.

Ylli Hoxha, në emër të LV- së, tha se shumica e këtyre informacioneve kanë ardhur si pasojë e komunikimit tonë intensiv me pronarët dhe qytetarët, të involvuar në një formë apo tjetër në këto raste.

Te rasti "Bingo - Benz", do të thotë se është vërtetuar se ekziston një aktgjykim, me të cilin prona e propozuar për këmbim si pronë komunale, nuk është pronë komunale, por është pronë e një pale private. Konsideroj se ky rast e ngrit një problem shumë serioz të Komunës, mos komunikimin e mirë të Zyrës ligjore me përfaqësuesin juridik të Komunës.

Po të mos ishte dyshimi i ngritur mbi rastin "Bingo - Benz", ne si Kuvend do të mund ta votonim edhe për këmbimin e pronës për pronarin Mufail Cakolli. Në hulumtim e sipër për këtë pronë, erdhën informatat se këto kanë qenë eksproprijuar njëherë. Kontrata është e nënshkruar në baza të dyshimta që prona i është konvertuar z. Mifail Cakollit në rrethana krejtësisht të dyshimta, pra me një sistem i cili nuk duhet t'i përket Komunës së Prishtinës.

Konsideroj se kjo çështje duhet të shndërrohet në një temë të veçantë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që ta diskutojmë më në thellësi sistemin e menaxhimit të pronave dhe të gjitha pronat të cilat mund të kenë çalime të njëjta ligjore.

Lidhur me çështjet e ngritura nga z. Hoxha, **Agim Salihu** dha sqarime të nevojshme.

Lirak Çelaj, në emër të GP-së së PDK-së, tha se unë nuk ia jap vetës të drejtën që ta gjykoj një vendim, të them se është fals, nëse nuk i kam ato dëshmi, dhe për këtë mendoj se janë institucionet kompetente të cilat merren me këtë punë.

Ndoshta kishte me qenë mirë që z. Salihu edhe njëherë të na i përshkruaj të gjitha hallkat të cilat i parasheh ligji. Ky proces a ka kaluar nëpër të gjitha hallkat, a e kanë marr konfirmimin prej të gjitha hallkave juridike, d.m.th. të gjitha institucioneve se ky proces është i ligjshëm. Nëse po, atëherë ne duhet të diskutojmë për diçka tjetër. Pra, unë nuk po e di se a jemi duke u marr si gjykatë, duke i vlerësuar, duke i gjykuar, apo jemi duke u marr me çështje të tjera. Unë jam i hutuar. Nëse kemi dyshime të bazuara, le të ngrihet një komision, por këtë punë do duhej ta bënte ekzekutivi aktual.

Muhamet Selmani kërkoi nga Kryetari të dijë se, përderisa po debatohet rreth këtyre pronave, para se me ardhur deri këtu, a është bërë verifikimi i tyre. Po ashtu kërkoi nga Zyra ligjore që të japë sqarime procedurale, se a janë verifikuar këto dokumente para se me u marr ky vendim. Do të ishte mirë që të na sqarohen këto gjëra, e pastaj kur të na vinë këto dokumente, ne të jemi më të përgatitur.

Remzi Pacolli, në emër të GP të AKR-së, kërkoi që në të ardhmen, të paktën kur të na dërgohen këto pika të rendit të ditës, të verifikohen në detale, e jo pasi të vinë këtu në seancë, që mos të bimë në lajthitje a ta votojmë, apo mos ta votojmë.

Shefki Gashi kërkoi nga Zyra ligjore që të japë një interpretim ligjor rreth procedurave të këmbimit të këtyre pronave. Lidhur me këtë çështje, tha se dokumentacionin që e posedojnë pronarët e atyre pronave, konsideroj se janë valide, andaj ne nëse e votojmë sot, bëjmë shkelje ligjore apo nuk bëjmë. Nëse bëjmë shkelje ligjore, nuk e votojmë, ndërsa nëse nuk bëjmë shkelje ligjore, unë e votoj dhe qëndroj prapa saj.

Fadil Gashi, në emër të GP të AAK - LDD-së, tha se propozojmë që kjo pikë të shtyhet, pasi që konsiderojmë se pronat ku janë propozuar për këmbim janë të kontestueshme.

Feti Mehdiu, në emër të GP-së së PD-së, tha se vendimi ynë si subjekt politik është ky, që për këto palët që janë me këto prona kontestuese, pa e parë, pa e ditur historinë mbi çfarë baze janë bërë pronarë këta të tre, pasi që shitja e pasurisë së Kosovës mbas vitit 2000 nuk është në rregull, të mos votohen.

Përderisa nuk kemi dokumente të mjaftueshme dhe pa i parë se mbi çfarë baze janë bërë këmbimet e këtyre pronave, unë nuk do t'i votoj.

Abetare Fazliu, në emër të GP-së së LB-së, theksoi se kjo çështje duhet t'i kthehet ekzekutivit, që ta shikojë edhe një herë lëndën dhe pastaj të silltet prapë në Kuvend.

Sylejman Pireva tha se duhet përshëndetur, madje dhe falënderuar, të gjithë ata që kanë kontribuar për të dal sot me fakte të reja rreth këtyre çështjeve kontestuese.

Konsideroj që seriozisht të merren këto fakte, çofshin të reja apo të vjetra, ato do të shihen më vonë, mirëpo ne të mos e votojmë këtë pikë.

Qëndron Kastrati tha se dua t'i drejtohem Zyrës ligjore, se në aspektin e informatës kush në kuadër të Komunës duhet t'i drejtohet Zyrës së avokaturës. Përderisa për një pronë është vendim i shkallës së parë të gjykatës, ku ia njeh të drejtën e pronës disa qytetarëve dhe ia pranon që nuk është pronë publike, pajtohem se vendimi nuk është i plotë fuqishëm, ka shkuar në shkallën e dytë d.m.th. prona është në kontest gjyqësor.

Dosja dhe rastet janë në Zyrën e avokaturës dhe kush në kuadër të Komunës duhet t'i drejtohet Zyrës së avokaturës. A është dashtë kjo dëshmi me na u paraqitur neve edhe pronarëve që ua ofron mundësinë e këmbimit, se kjo pronë është në kontest gjyqësor dhe është vendim i shkallës së parë, i cili nuk është i plotfuqishëm, por është në favor të palës që e ka paditur Komunën?

Çështja e dytë është se, Ministrisë kur i janë dërguar dokumentet, a ka qenë i përfshirë edhe ky vendim jo i plotfuqishëm i gjykatës, e cila vendos në favor të palës, e cila e ka paditur Komunën?

Mendoj se këtë çështje duhet t'ia kthejmë ekzekutivit që ta shqyrtojë edhe një herë.

Abit Kastrati tha se prona ku është propozuar t'i jepet pronarit të "Bingo Benz"-it, në vitet e 70 është blerë nga Komuna. Më pas ish-pronari i saj u bë pronar i asaj toke dhe ia ka dhënë për shfrytëzim një emigranti i ardhur nga Shqipëria. Por, në mungesë të provave, të cilat ne nuk mundemi me i gjetur këtu, propozoj që kjo lëndë të kthehet prap te ekzekutivi që të hulumtohet më tutje.

Kimet Zeqa tha se nëse prona e pronarit (Mifailit) është kontestuese edhe nuk është përcjellë nëpër zyrat ose nëpër avokatura, ose nuk është marrë fletë poseduese, nuk e di se çka do të bisedojmë më tutje. Kërkoj që për këto çështje gjithmonë të kemi dëshmi, që të shkojmë më tutje. Pra, do të ishte mirë që lënda të dërgohet në Zyrën e avokaturës.

Lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësit, të cilët kërkuan interpretim ligjor nga Zyra ligjore, **Agim Salihu** dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi tha se po përballemi me disa çështje që kanë ndodhur deri tash dhe që kanë ndodhur në ndërkohë, d.m.th. kemi dokumentacion që procedurat kanë kaluar dhe janë verifikuar si të ligjshme. Por, në ndërkohë po shohim se kanë ndërruar çështjet, kështu që mbetet që ekzekutivi të sigurojë materiale të nevojshme dhe kur të përgatitet për këto lëndë, të na i sjellë në Kuvend.

Pika e tetë

Lidhur me diskutim për lagjen "Dodona", Kryetari i njoftoi të pranishmit, duke shtuar se çështja për të cilën po debatojmë tani është prona përballë Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjegjësisht hapësira afër xhamisë. Në këtë hapësirë kanë qenë 16 familje, të cilave iu kanë rrëzuar shtëpitë me një marrëveshje, që më pas atyre t'iu jepet mundësia për ndërtim. Sipas planit, këtu parashihet diku ndërtim i lartë dhe Komuna ka vendosur në të kaluarën që të shpall këtë pjesë këtu si zonë të interesit publik, që do të thotë se Komuna e ka shpallur si tokë që duhet të shpronësohet. Në

anën tjetër, Ministria e Kulturës ka thënë se nuk mund të ndërtohet ose duhet të jetë ndërtim i ulët, për shkak se është shumë afër xhamisë, objektit të trashëgimisë kulturore. Për ta zhvilluar këtë procedurë mbesin dy opsione të hapura, njëra është që me vazhduar me këtë këmbim, ndërsa tjetri opsion është shfuqizimi i vendimit të mëparshëm. Kjo është një çështje tepër e rëndësishme, nuk është vetëm një ndërtesë, është një pjesë e qytetit, në të cilën do të ndërtohen objekte deri në 8-9 kate.

Sami Hamiti tha se kjo lëndë është proceduar pak më gjatë. Plani rregullues është prej vitit 2005, është para Ligjit për mbrojtje të monumenteve. Në ndërkohë, deri në vitin 2013, nuk kemi pasur Ligj të këmbimit të pronës, kemi pasur Ligjin për shpronësimin e pronës. Pasi është analizuar mirë nga ekzekutivi, është planifikuar që në të ardhmen me planet në pjesën

e vjetër, në pjesën historike të qytetit, që quhet nga Xhamia e madhe deri te pjesa të bëhet shëtitore dhe të bëhen dy kalime anash. Tani duhet të definohet kjo. Nëse Kryetari thotë që duhet ta rrisë vlerën e pronës dhe ta bëjë ndërtim, bie në kundërshtim me atë që themi ta bëjmë krejt gjelbërim. Prandaj mbetet që Kryetari ta marrë një qëndrim më të qartë. Përndryshe, qëndrimi i LDK-s është që kur është vendosur që të bëhet trajtimi i kësaj hapësire, është menduar shumë mirë. Për këtë është planifikuar më gjerë jo vetëm aty, dhe e konsiderojmë si vendim që është i ligjshëm, gjithsesi në kuptimin e saj që është një vendim i mirë, por nëse Kryetari mendon se duhet të tërhiqet, le të tërhiqet dhe debatohet procedurë tjetër.

Ylli Hoxha, në emër të GP-së së LV-së, theksoi se prej fillimit e kemi konstatuar se shkëmbimi i propozuar ka qenë ekonomikisht jo i dobishëm, i pa arsyeshëm, do të thotë pas vendimit të Ministrisë së Kulturës, se ndërtimi i lartë nuk lejohet në pjesën e ish- "Voçar"-it. Është konstatuar se duhet shndërruar ajo pjesë në park dhe të kompensohet pronari i ish- "Voçar"-it. Në këtë pikëpamje nuk është dashur fare të futemi në këtë transaksion dhe mos ta ndjekim fare procedurën që e kemi ndjekur. Është mirë që në Komitet për Politikë dhe Financa kemi arritur ta stopojmë.

Prandaj, mendoj se duhet reviduar ky plan, duhet menduar se cila është zgjidhja më e mirë për Komunën, për banorët dhe për pronarët e parcelave të cilët kanë hall, sepse janë bllokuar për vite të tëra. Konsideroj se kjo çështje duhet të shndërrohet në një çështje urgjente të ekzekutivit dhe pasi që të elaborohen të gjitha mundësitë, të na sillen edhe njëherë në Kuvend.

Lirak Çelaj, në emër të GP-së së PDK-së, tha se qëndrimi im është që këtu të mos lejohet ndërtim aspak. Kam qenë gjithmonë ithtar i ruajtjes së Prishtinës së vjetër, e cila është dëmtuar vazhdimisht jo vetëm nga regjimi i kaluar, por edhe pas luftës është rrënuar dhe është dëmtuar shumë. Në rast se merret vendimi që të ndërtohet, mund të jetë një kompromis në mes pronarëve, duke përfshirë këtu si pronar edhe Komunën.

Unë jam për të mbrojtur interesin e qytetarëve, jo për ta dëmtuar, mos të shkojmë në ekstremin tjetër. Ne duhet të kemi parasysh rrethanat dhe mënyrën se si ka investuar ai, dhe nëse nuk instalojmë praktika të tilla, do të jetë demotivuese për njerëzit të cilët merren me privatizim, me biznes etj. kështu që unë mendoj se duhet t'i kemi të gjithat parasysh. Propozimi ynë është që të mbetet park dhe të rishikohet, por në rast se shumica vendos ndryshe, atëherë ndoshta mund të bëhet kompromis, që të trajtohet prona si e përbashkët dhe të kompensohet prona në përqindje në objektin e ndërtuar.

Remzi Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se këtë çështje Kryetari le ta studiojë mirë se cili është kalkulimi më i mirë për Komunën, le ta japë një version dhe pastaj le të sillen prapë në shqyrtim. Të studiohet mirë kjo çështje se a do t'i kushtojë Komunës më lirë shndërrimi i kësaj prone në park, për t'i shpronësuar objektet tjera që janë aty banorë tjerë, apo do ta bëjë ndërtimin, kështu që ne jemi që të kthehet kjo edhe një herë në ekzekutiv, ta bie një propozim Kryetari, e pastaj le të sillen prapë në Kuvend.

Feti Mehdiu, në emër të GP-së së PD-së, tha se sugjerimi im ishte që për këtë propozim, i cili u debatua në vitin 2013, Kryetarit të atëhershëm i kam sugjeruar se duhet ta keni parasysh se rreth xhamisë ka shumë hapësirë e cila i takon xhamisë, i takon popullit, xhamia është me popull, edhe Parlamenti është me popullin, nuk janë objektet si ju thoni ju ose administrative, zyra ose tregtare, nuk janë me popullin ato.

Ajo që është si pjesë e hapësirës që i thoni e Komunës, Komuna nuk ka çka të kërkojë asnjë metelik aty, për shkak se Komuna është në shërbim të qytetarëve të Prishtinës dhe ajo pjesë që është, u bisedua atëherë ta bëjmë, prej aty ta qesim kënde, por mendoj se një propozim i tillë nuk qëndron. Mendimi ynë është që aty të mbetet një park në shërbim të qytetarëve.

Ibrahim Mehmetaj, në emër të GP-së së LB-së, propozoi që kjo pikë të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme. Po ashtu tha se LB konsideron se është në interes të qytetarit që kjo pjesë të jetë gjelbërim dhe Komuna e Prishtinës të futet në marrëveshje për shpronësim të pronave.

Shefki Gashi paraqiti shqetësim rreth rrjedhjes së debatit për këtë pikë, duke cekur se është përgjegjësi e jona, e të gjithëve, që atyre qytetarëve t'iu bëjmë një zgjidhje e mos ti lëmë në rrugë, pra duhet shikuar edhe interesin e tyre. Aty është dhënë prona, është ndërruar, është aprovuar të ndërtohet objekti, andaj dhe duhet me ua lejuar ndërtimin.

Kërkoj nga Kryetari që mos ta shtyjë këtë çështje, ta aprovojmë, ta bëjmë ndërrimin e pronës, e që në anën tjetër xhamisë t'i lëmë hapësirë që aty ta bëjmë një park të bukur, ku mund ta vendosim edhe ndonjë shtatore të kujtdo çoftë dhe pjesa tjetër të mbetet për ndërtim.

Muhamet Selmani tha se, nëse nuk është e mundur që t'iu bëhet asnjë zgjidhje tjetër këtyre pronarëve që janë këtu, ne mund t'iu japim prapë leje për lokalet qysh i kanë pas, jo tash të ju japim një parcelë me ndërtuar tetë kat. Në çoftë se është e mundur apo nëse nuk është një shumë e cila qon shumë peshë, sepse janë vetëm dhjetë arë tokë. Propozoj që aty të bahet një shesh dhe ta vendosim shtatoren e heroit "Adem Jashari" të cilit nuk i kemi lënë vend askund.

Sadri Ramabaja tha se po më gëzon një fakt, se përveç asamblistëve të LV-së, ka një pajtueshmëri mjaft të gjerë që ajo pjesë të trajtohet si park.

Javën e kaluar e kam publikuar një shkrim dhe po planifikoj që në rrugë zyrtare t'ia dorëzoj kryesisht së Kuvendit, që ta procedoj në javët pasuese, relativisht në mbledhjet e ardhshme, propozimin që është bërë tash publik.

Ideja që të shndërrohet në park, duket që ka mbështetje më të gjerë. Këtu nuk bëhet fjalë për luftë kundër investitorëve, kundër njerëzve që duhen të shumëzohen profitin etj. Komuna mund t'i kompensojë shumë mirë diku tjetër dhe ata do duhej të ishin të kënaqur. Megjithatë, në trajtim e sipër do të vërehet se aty ka edhe uzurpues dhe natyrisht uzurpuesit nuk është Kuvendi i thirrur që ti shpërblej as këtu, as te katedralja, e as diku tjetër. Do të ishte në nderin e këtij Kuvendi që, të gjithë së bashku, ta miratojmë idenë, që le t'ia dhurojmë një park si duhet në qendër, meqë është mundësia relativisht e mirë, dhe më duket se nuk ka asgjë kundër. Ajo çka nuk duhet të keqkuptohet është se pronarët legjitim, megjithatë duhet trajtuar konform interesave të tyre dhe ata sigurisht që do të kompensohen.

Visar Arifaj, në emër të subjektit politik të PF-së, tha se zgjidhja e vetme logjike këtu është nëse ndërtojmë një park. Mendoj se çdo ndërtim i lartë në atë hapësirë, nuk do të bënte zgjidhje. Për këtë arsye them se sado që na kishte kushtuar neve si Komunë me i kompensuar familjet që janë dëmtuar këtu, ia vlen, për shkak se nuk është vetëm për sot, është diçka që do të mbetet edhe në të ardhmen. I mbetet njollë tani qytetit nëse nuk ishte bërë park menjëherë, nëse ish ndërtuar aty një banesë, thjeshtë e kemi shëmtuar qytetin edhe nuk ka kthim më mbrapa.

Mustafë Krasniqi, tha se kjo është zgjidhje e mundshme më e mirë dhe më optimale që është e pranueshme edhe për ne, edhe për të gjithë, andaj dhe kemi marr një vendim të tillë që t'iu bëhet zgjidhje atyre pronarëve, duke menduar që pa e ngarkuar Komunën në aspektin e kompensimit të tyre, por në formën më të mundshme. Nga diskutimet po propozohet që aty

të bëhet një park, mirëpo konsideroj se duhet të bëhet një analizë pak më detale në biseda me të gjithë pronarët, dhe duhet të shihet se sa vërtet Komunës do t'i kushtojë ajo. Unë mendoj se do t'i kushtojë shumë, edhe vështirë do të jetë e pranueshme për ta, por vështirë do të jetë edhe nga ana e vetë ekzekutivit dhe Kryetarit për kompensimin me të gjitha dëmet që njerëzve iu kanë shkaktuar. Mendoj se për këtë duhet menduar mirë se si të veprohet, që duke pasur parasysh presionin e atyre qytetarëve dhe investimeve që janë bërë, sigurisht se do ta shtyjë Kryetarin dhe ekzekutivin, por edhe neve, jo të mendojmë shumë gjatë, por të marrim veprime sa më të shpejta.

Kryesuesi tha se në bazë të të gjitha diskutimeve, konstatoj se kjo çështje do t'i mbetet ekzekutivit, që ta analizojë mirë e mirë se cila zgjidhje është më e mira, të përgatitet me materiale dhe të shqyrtohet në njërin nga mbledhjet e radhës së Kuvendit.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës së Prishtinës, tha se në bazë të këtij diskutimi, mund të konstatohet se ekzekutivi vjen me një propozim, i cili vendoset karshi propozimit ekzistues dhe vendosim si Kuvend komunal se cila është rruga më e mirë, rrugë e cila e ruan interesin e pronarëve, interesin publik.

Pika e nëntë

Për gjendjen rreth furnizimit me ujë në komunën e Prishtinës, të pranishmit i njoftoi Ilir Avdullahu, drejtor teknik i ujësjellësit rajonal "Prishtina".

Sami Hamiti tha se nëse i referohemi puseve të Fusha e Pajtimit, ato puse janë në tangjentin e një përroi që shkon aty dhe e dimë sa ka kanalizime që shkojnë në atë pjesë. Nuk do të ishte mirë që drejtpërdrejt prej atyre puseve të bëhet kyçja në rrjetin primar të ujësjellësit, nëse është e vërtetë, nuk është mirë dhe ai ujë nuk kontrollohet, Ndërkohë ai furnizim prej atyre puseve është ndërprerë kur ka filluar të ndërtohet liqeni i Badovcit, pasi që edhe u konstatua se ai ujë është bakteriologjik. Gjithashtu duhet të jetë një plan dinamik, së bashku me infrastrukturën, pasi që shumë punë ndërlidhen me infrastrukturën rrugore.

Lirak Çelaj pyeti se në cilin vit ka filluar realizimi i këtij projekti, pra instalimi i tubacionit për disa lagje të qytetit, kush janë investitorët, kur përfundon ky projekt.

Cili është roli i Komunës në gjithë këtë projekt? A është përshtatur projekti në lagjet me zhvillimet që kanë ndodhur dhe a janë bërë përshtatjet konform zhvillimit të rritjes së qytetit?

Shefki Gashi ngriti shqetësim rreth furnizimit me ujë nga disa puse në fshatin Llukar, duke thënë se ai burim i ujit nga ai vend më parë është ndaluar të përdoret, për shkak se s'ka shkaktuar tifon e zorrëve. Konsideroj se uji i nxjerrë nga këto puse është i papërdorshëm dhe nuk fabrikohet fare. Pasi ne e dimë që ai ujë teknikisht nuk është në rregull. Sepse nxirret pranë kanalizimit dhe nuk shkon në fabrikë, si i tillë nuk guxon të përdoret për pije.

Ylli Hoxha tha se nga prezantimi i përfaqësuesit të kësaj kompanie, u konstatua se në të kaluarën ka ekzistuar një koordinim bukur i dobët në mes të kompanisë së Ujësjellësit dhe Komunës së Prishtinës. Lidhur me këtë, shtroi pyetjen se cilat janë masat që duhet të parashihen për të përmirësuar këtë komunikim, në mënyrë që çështjet e furnizimit me ujë, të cilat ndërlidhen me projektet infrastrukturore, të jenë të ndërtuara me Komunën dhe me dikasteret e saj për infrastrukturë. A ka paraparë kompania masa të tilla për të përmirësuar evitimin e situatave, siç është çështja e rrugës së UÇK-së, pra, përshtatjes së një planifikimi politik të Prishtinës? Cila është gatishmëria e kompanisë që të subordinohet në projektet politike të cilat kanë marrë mandatin për të qeverisur kryeqytetin.

Konsideroj se furnizimi i objekteve institucionale duhet të ketë një prioritet me furnizim të ujit. Jemi në krizë dhe a janë marrë masa për të siguruar furnizimin e rregullt për objektet institucionale, që nënkupton shkollat, spitalet dhe institucionet tjera të cilat duhet të kenë prioritet në raste të tilla.

Kimet Zeqa ngriti një shqetësim, duke cekur se nëpër banesa kolektive pagesa e ujit bëhet paushall, sepse nuk ka orë që do të lexoheshin. Për këtë çështje kam kërkuar sqarim nga kompania dhe deri më tani nuk kam marr asnjë përgjigje.

Hatixhe Hoxha pyeti se kjo kompani a ka ndonjë sektor që bën, harton strategjinë për raste sikur thatësira, vërshimet etj. Mendoj se duhet të ekzistoj një marrëveshje, ose një bashkëpunim i ngushtë në mes të kompanisë së ujësjellësit dhe Drejtorisë së Infrastrukturës, për shkak se ndërliidhen shumë punë në mes tyre. Konsideroj se në këtë drejtim ka edhe një defekt të sheshi “Nëna Terezë”, e që dëshiroj të di se a ka pasur ndonjë komision i cili e ka mbikëqyrë punën e asaj kompanie e cila ka bërë shtruarjen e pllakave, për shkakun se kundërmon era atje prej kanalizimit. Mendoj se nuk ka qenë një koordinim i rregullt në mes të ujësjellësit, Drejtorisë së Infrastrukturës dhe kompanisë që i ka shtruar ato pllaka.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, për përfaqësuesin e kompanisë parashtror këto pyetje:

-A po pompohet uji në Badovc, i cili vjen përmes kanalit “Ibër - Lepenc”, sa shpesh i bëhen analizat këtij uji, çfarë rezultatesh kanë dalë, për shkakun se kanali “Ibër - Lepenc” kalon nëpër shumë komuna?

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha **Ilir Avdullahu**, drejtor teknik i ujësjellësit rajonal “Prishtina”.

Pika e dhjetë

Pyetje dhe përgjigje.

Remzi Pacolli, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale:

Lidhur me pyetjen e parashtruar ngriti një shqetësim, duke cekur se kompania e cila e ka punuar rrugën në fund të Veternikut, në anën e djathtë të rrugës në drejtim për qytet, ka hedhur një shtresë beton dhe ajo pjesë e rrugës është bërë shumë e vrazhdë dhe po e pengon qarkullimin e rregullt të komunikacionit.

Kërkoj nga drejtorja që të ndikojë te kompania e cila është duke punuar në atë rajon, ta heqë atë shtresë të betonit dhe ta bëjë asfaltimin e atij segmenti rrugor në gjatësinë prej 20 m.

Hysen Durmishi, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, tha se jemi përpjekur ta mirëmbajmë atë pjesë disa herë, kemi intervenuar aty, mirëpo brenda dhjetë ditësh do të lëshohet në qarkullim pjesa, gjegjësisht ana e djathtë e rrugës. Me lëshimin në qarkullim të këtij segmenti rrugor, do të evitohet ky problem dhe do të lehtësohet shumë komunikacioni në këtë pjesë, në mënyrë që kompania të punojë në pjesën tjetër të rrugës.

Feti Mehdiu, pyetje për Drejtorinë e Financave dhe Pronës:

Lidhur me pyetjen e paraqitur, ngriti shqetësimin e qytetarëve të lagjes “Dardania”, duke cekur se me çfarë baze janë pronarë të ish-objektit “Novi Dom” katër pronarë.

Çështje tjetër ku ceket se tani në këtë objekt është xhamia “Dardania”, e cila nuk është e evidencuar në shërbimin kadastral, andaj dhe shtrohet pyetja se a ka mundësi që Agjencia e Kosovës për Privatizim ta shesë atë pronë pa dijeninë e kompetentëve të Komunës. Për këtë

çështje ata kanë paraqitur edhe një dokument tek gjykata, që janë rreth 3000 nënshkrime që janë dhënë nga qytetarët e asaj lagje.

Pika e njëmbëdhjetë
Të ndryshme

Ylli Hoxha tha se, me që jemi në fund të mbledhjes dhe numri i asamblistëve është i reduktuar, meqë jemi në situatë të tillë, ndoshta me dakordim, çështjen e nepotizmit të cilën e propozova në fillim, ta lëmë për seancën e ardhshme, dhe shpresojmë që në ndërkohë mediat të mos na bëjnë sulme të tjera të pareshtura, çfarë i kemi pas në muajin paraprak.

Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Hoxha, **Sami Hamiti** tha se për çështjen e nepotizmit sqarime të nevojshme mund të merren nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke iu referuar Ligjit për konflikt interesi.

Mbledhja mbaroi në orën 17:30.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl